

Përmbledhje

Projekt kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK)

Shkurt 2012

Titulli i projektit	Projekt kundër Krimit Ekonomik në Kosovë
Buxheti	1,200.000 Euro: 83.3% Bashkimi Evropian dhe 16.7% Këshilli i Europës
Financimi	IPA 2010: Marrëveshje e drejtpërdrejtë granti e BE-së
Zbatimi	Departamenti i Veprimit kundër Krimit Drejtoria e Shoqërisë Informative dhe Veprimit kundër Krimit, DG I- Këshilli i Evropës
Kohëzgjatja	30 muaj (fillimi 1 shkurt 2012)

1 HYRJA DHE JUSTIFIKIMI

Krimi ekonomik – duke përfshirë korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin e kibernetikes dhe forma të tjera të krimit financiar dhe të organizuar përbëjnë çështje të rëndësishme në Kosovë. Në lidhje me krimin ekonomik, Këshilli i Europës ka mbështetur Kosovën për disa vite nëpërmjet veprimtarive të bashkëpunimit teknik të fokusuar tek mbështetja për hartimin legjislativ, trajnimin dhe këshillim politikash në bashkëpunim me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Shtetin e së Drejtës në Kosovë (EULEX Kosovë). Ky përfshin hartimin e kodit më të fundit (provizor) penal dhe të procedurës penale, legjislacionit specifik për procedurën e ndjekjes dhe investigimit, legjislacionin kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, forcimin e kapaciteteve për agjencinë anti-korrupsion, trajnimin në lidhje me përdorimin e mjeteve speciale të hetimit, hetimet financiare, mbrojtjen e dëshmitarit dhe masa të tjera kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Në “Komunikatën për Këshillin e Europës dhe Parlamentin Evropian” mbi “Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011”, Komisioni Evropian vjen në konkluzionet si në vijim: “...Korniza ligjore mbi anti-korrupsionin është përmirësuar me adoptimin e ligjeve mbi Agjencinë anti-korrupsion dhe mbi deklarimin dhe prejardhjen e pronës dhe dhuratave për zyrtarët e lartë publik. Ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike është amendamentuar. Ligji mbi financimin e partive politike nuk është në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, rezultatet në luftën kundër korrupsionit janë të kufizuara...” dhe konkluzionet e njeja e adresojnë çështjen e pastrimit të parave si “Pastrimi i parave mbetet një çështje shqetësuese dhe serioze. Kosova ka adoptuar një ligj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Bashkëpunimi midis Shërbimit të Doganave dhe Qendrës së Inteligjencës Financiare është përmirësuar. Qendra po ashtu e ka përmirësuar bashkëpunimin me bankat. Megjithatë, Kosova është akoma në një fazë të hershme në adoptimin dhe implementimin e standardeve Europiane në këtë fushë. Kapacitetet për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e shpërlarjes së parës janë ende të dobëta...”

Rezultatet e një vlerësimi paraprak të nevojave mbi krimin ekonomik (korrupsion dhe pastrim parash/anti-terrorizëm) të dhëna nga Sekretariati i Këshillit të Europës (KiE) në tetor 2009 dhe gjatë vitit 2010-2011, paraqitën një numër të madh çështjesh të mbetura në lidhje me forcimin e shtetit të së drejtës përmes masave dhe institucioneve të efektshme kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe formave të tjera të krimit ekonomik.

Agjencia Anti-Korrupsion e Kosovës (AAK) është funksionale që me krijimin e saj në 2006 dhe ka arritur të rrisë dhe të forcojë kapacitetet e saj dhe së fundmi po funksionon sipas një ligji të ri të ndryshuar. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Çështjeve Gjinore (OGG) koordinon gjithashtu çështjet që lidhen me politikat e korrupsionit si dhe siguron këshillim dhe përfshirje të përpjekjeve të duhura për qeverisje të mirë në një përjasje ndër sektoriale.

Në të njëjtën kohë, Njësia e Hetimit Financiar (FIU) dhe Qendra e Hetimit Financiar (FIC- Njësia e tipit klasik për Hetimet Financiare) duket se po përballen me shumë sfida për rritjen e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore që nga krijimi i tyre dhe veprimtaritë që financoheshin kryesisht nga ofrues të asistencës ndërkombëtare. Pavarësisht disa masave që janë marrë, përsëri korrupsioni dhe pastrimi i parave mbeten problem dhe mbizotërojnë në jetën sektoriale të Kosovës. Në vitet e fundit, në Kosovë janë bërë hapa të rëndësishme për të afuar me standardet ndërkombëtare kuadrin ligjor dhe

* Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst do të kuptohen në pajtueshmëri të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe pa paragjykim në lidhje statusin e Kosovës

institucional në lidhje me krimin ekonomik. Së fundmi, në Kosovë janë miratuar një sërë ligjesh të rëndësishme: Mbetet të vlerësohet nëse kuadri i përgjithshëm ligjor, duke përfshirë më të fundit, plotëson standardet europiane dhe ndërkombëtare, si dhe niveli i tij i zbatimit. Kuadri ligjor edhe pse i ndryshuar shumë shpesh përsëri kërkon një proces orientimi dhe/ose mbetet i paqartë në një nivel të caktuar.

Ndërsa reformat që lidhen me korrupsionin dhe pastrimin e parave kanë qenë në proces për disa vite, nuk ka pasur proces të vlerësimit të efikasitetit dhe ndikimit të këtyre reformave; institucionet kryesore ekzistojnë në shumicën e fushave- dhe disa të tjera janë bërë rishtazi funksionale (si Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar apo Sekuestruar)- por statusi i tyre varion ndjeshëm, ndonjëherë kompetencat mbivendosen ose nuk janë të qarta.

Një përpjekje e përbashkët e BE-së dhe KiE-së bazuar në përvojën e shumë projekteve të përbashkëta të suksesshme në këtë fushë do të ishte një përjasje e duhur për të siguruar ndjekjen zbatimin të zbatimit të standardeve dhe praktikave europiane në Kosovë. Një përpjekje e tillë do të kontribuonte në reforma koherente kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë, edhe në përfitim të EULEX Kosovë, duke i bërë kështu më të qëndrueshme rezultatet e reformave dhe duke i përafëruar me standardet europiane. Standardet e Këshillit të Europës, Bashkimit Europian dhe organizatave të tjera të rëndësishme duhet të shërbejnë si kuadër reference dhe të ndihmojnë në caktimin e piketave, vlerësimin e masave kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në Kosovë. Në përgjithësi, përparësia e Këshillit të Europës qëndron në faktin që veprimtaritë për vendosjen e standardeve në këtë fushë mbështeten nga monitorimi dhe bashkëpunimi teknik. Megjithatë, Kosova nuk mund të marrë pjesë dhe kështu të përfitojë nga këto organe monitoruese. Pavarësisht kësaj, përvoja dhe kriteret e përdorura nga mekanizmat monitorues të Këshillit të Europës – siç janë Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) për korrupsionin dhe Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) për pastrimin e parave- besohet se janë të dobishme nëse orientohen specifikisht dhe adoptohen për t'i lejuar vlerësimet thelbësore dhe periodike gjatë periudhës 30 mujore në Kosovë në kornizën e një projekti.

2 BAZA E ARSYETIMIT

Këto modele duhet të jenë referencë në kuadër të vlerësimit dhe rishikimit të masave kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë dhe përgatitjes së rekomandimeve për reforma. Gjithashtu, këto rekomandime për reforma do të bashkohen dhe orientohen, dhe do të shërbejnë për të::

- (1) vlerësuar dhe caktuar standarde për masat aktuale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit (korrupsion, pastrim i parave dhe financim i terrorizmit); dhe
- (2) ofruar rekomandime dhe mjete në drejtimin e reformave të nevojshme dhe të rëndësishme që synojnë forcimin e masave kundër krimit ekonomik në Kosovë.

Për herë të parë një program i hartuar në mënyrë të veçantë do të ketë si qëllim, strategji dhe burime, marrjen përsipër të vlerësimeve të rregullta dhe të plota në Kosovë për çështje të krimit ekonomik dhe më specifikisht: korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Raunde të vlerësimit do të mbulojnë fushën institucionale, ligjore, të politikave dhe të burimeve të ndara në tema të veçanta të modeluara kryesisht sipas mekanizmave të Këshillit të Europës (GRECO dhe MONEYVAL).

3 OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM, KOMPONENTËT DHE REZULTATET E PRITSHME

Objektivat e veprimt	Objektiva e Përgjithshme Dhënia e kontributit për demokracinë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë Qëllimi Forcimi i kapaciteteve institucionale për ta luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet Europiane bazuar në vlerësimin e detajuar dhe ofrimin e rekomandimeve
Rezultatet Pritshme	Rezultati 1- Vlerësimi i Masave Anti-Korrupsion 1.1 Raportet e vlerësimit dhe progresit të gatshme mbi nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave me standardet Evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga GRECO dhe organet e tjera relevante ndërkombëtare); 1.2 Institucionet e Kosovës të afta që ta përkrahin dhe udhëheqin vlerësime të llojit të njejtë bazuar në metodologjinë Europiane të monitorimit; 1.3 Rekomandimet e gatshme mbi fushat që kanë të bëjnë me legjislacionin, institucionet dhe politikat 1.4 Raportet e Vlerësimit dhe progresit (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) të publikuara dhe të shpërndara në gjuhët Angleze, Shqipe dhe Sërbe.

	Rezultati 2- Vlerësimi i masave kundër shpërlarjes së parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit 2.1 Raportet e vlerësimit dhe progresit mbi nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve të aplikueshme dhe praktikave me standardet Europiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorua nga MONEYVAL dhe organet e tjera relevante ndërkombëtare); 2.2 Institucionet e Kosovës të afta që ta përkrahin dhe udhëheqin vlerësime të llojit të njëjtë mbi masat kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit bazuar në metodologjinë Europiane të monitorimit. 2.3 Rekomandimet e gatshme mbi fushat që kanë të bëjnë me legjislacionin, institucionet dhe politikat 2.4 Raportet e vlerësimit dhe progresit (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) të publikuara dhe të shpërndara në gjuhët Angleze, Shqipe dhe Sërbe.
Partnerët Kryesor	- Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës - Agjencia Anti-Korrupsion (AAK) - Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF)

4 METODA E IMPLEMENTIMIT

Këshilli i Europës do të jetë përgjegjës për implementimin e projektit dhe përdorimin e fondeve të tij sipas një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë granti me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë. Këshilli i Europës do të jetë organizata përgjegjëse e që do të sigurojë realizimin e rezultateve të lartpërmendura të projektit.

Këshilli i Europës do të rekrutojë një Këshilltar afatgjatë (LTA) dhe një Zyrtar lokal projekti (ZLP) me qendër në Prishtinë dhe do të punojnë direkt me institucionet në Kosovë. Ky ekip do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit në Kosovë në emër të Këshillit të Europës. Përveç kësaj, bazuar në kalendarin e aktiviteteve (vizitave në vend, vlerësimeve, revizioneve, përgatitjeve për vlerësime dhe finalizimet e raporteve të vlerësimeve të projektit). Këshilli i Europës do të angazhojë ekspertë afat-shkurtër ndërkombëtarë dhe vendor të cilët do përbëjnë ekipin vlerësues për dy komponentat e përmendura më lart.

Autoritetet përfituese/koordinuese dhe specifikuat Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZQM), do ta dezinjojnë Koordinatorin e Projektit për të siguruar përçimin e informacionit dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet relevante; për më tepër Agjencia Anti-Korrupsion e Kosovës dhe Qendra e Hetimit Financiar (FIC) do të kërkohet të caktojnë dy pika kontakti lokal për projektin si ekspertë në çështjet përkatëse (korrupsion dhe pastrim i parave). Ai/Ajo do të funksionojnë si partnerë kryesor përgjegjës për koordinimin e veprimtarive të projektit në emër të institucioneve/autoriteteve të Kosovës.

Projekti do të ketë një Komitet Drejtues (i cili do të përbëhet nga përfaqësues nga të gjitha grupet e përfituesve/synuara dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë si dhe Këshillit të Europës.

5 KONTAKT

Seksioni i Krimin Ekonomik

Njësitë e Korrupsionit dhe Mashtrimit (CFU)/Divizioni i Krimeve Ekonomike (ECD)

Drejtorati i Bashkëpunimit- DGHL

Këshilli i Europës

F-67075 Strasbourg, Cedex FRANCE

Tel: +33 3 88 41 26 29; Fax: +33 3 90 21 5650

ardita.abdiu@coe.int

www.coe.int/economiccrime